



Buletini Mjedisor

KUR PREMTIMET BËHEN REALITET....

Një nga sfidat e Qeverisë së re të ardhur në Qershor 2013, për fushën e Mjedisit, ishte kthimi në normalitet i peisazheve,



parqeve dhe zonave të mbrojtura shqiptare, të cilat edhe pse deklaroheshin se zinin 12% të sipërfaqeve të vendit, realisht ishin vetëm disa zona që kur i vizitoje më shumë ndieje keqardhje se kënaqësi.

Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka që në ditët e para të punës së tij deklaroi se do punonte që këto zona të ktheheshin prapë në zona relaksuese. Kështu, filloi puna për Parkun Kombëtar të Divjakës, për Kodër Vilë në Durrës, si dhe për Parkun e Lurës.

Tashmë pa u mbushur dy vjet nga ky premtim shohim rezultatet e para. Në numrin e kaluar ju njohëm me pamje nga kthimi i pelikanëve.

Këtë radhe do donim t'ju njihim me rezultatet e para të Kodrës Vilë në Durrës. Kjo kodër për më shumë se 10 vjet nuk ofronte asnjë kënaqësi estetike, ndërsa gjatë këtij muaji përfundoi faza e parë e punimeve për rehabilitimin e saj, një nga projektet e rëndësishme të Ministrisë së Mjedisit.

Për përfundimin e fazës së parë punimet u inspektuan nga Kryeministri i vendit, Z. Edi Rama, Ministri i Mjedisit, Z. Lefter Koka, Kryetari i Bashkisë së Durrësit, Z. Vangjush Dako, Deputeti Spartak Braho dhe Prefekti i Qarkut Roland Xhelili inspektuan nga afër punën e bërë në Kodrën të njohur si problematike për qytetarët e Durrësit.

Kryeministri Rama u shpreh se degradimi i kësaj zone ishte një

goditje e rëndë për potencialin turistik të Durrësit dhe ky investim e kthen në një atraksion të rëndësishëm për qytetin.

“Për qytetarët e Durrësit, kjo ishte e njohur si kodra e

rreshqitjeve të dherave dhe e rreziqeve të vazhdueshme, ndërsa për gjithë vizitorët e panumërt nga Tirana apo nga kudo, kjo ishte një goditje në sy që pengonte të shijohesh kjo zonë me një potencial kaq të rëndësishëm turistik. Falë kësaj ndërhyrjeje të qeverisë shqiptare, këtu kemi një transformim rrënjësor, janë mbjellë 50 mijë fidanë dhe brenda një harku 2-3 vjeçar do të kemi një pamje të transformuar të një kodre të gjelbëruar dhe një larmi bimësie, që do të jetë vërtet një atraksion i rëndësishëm për të gjithë ata që do të shfrytëzojnë vijën e shëtitjes në ajër të pastër. Një vijë shëtitjeje që synojmë ta zgjasim e ta çojmë deri tek Kodra e Vilës, për t'i dhënë qytetarëve të Durrësit, një kilometër shëtitorë të re”.

Kryeministri theksoi faktin se qeveria mbetet e angazhuar për të korrigjuar gabimet e së shkuarës në qëndrimin ndaj mjedisit dhe pyjeve.

“Kam shumë kënaqësi të them se vetëm në vitin e parë të qeverisë, pra, të vitit të parë të mbjelljes kemi kapur kuotën e 2.5 milionë fidanëve dhe jemi në një proces ripërtëritjeje të një plage të tmerrshme, të hapur për 20 vjet rresht me shkatërrimin e pyjeve dhe dëmtimin masiv të florës së vendit tonë. Durrësi, për ne, ka

qenë e mbetet një prioritet strategjik dhe në kuadrin e kësaj qasjeje, edhe ky investim është një shenjë shumë e fortë për rilindjen që duam për Durrësin dhe gjithë Shqipërinë”.

Ndërsa Ministri i Mjedisit e cilësoi një model për zona të tjera të ngjashme, me rëndësi ekonomike dhe turistike. “Një model që edhe një zonë që kishte humbur çdo shpresë dhe kishte humbur besimi i njerëzve mund të transformohej në një lulishtë dhe sot do ta konsideroj me plotë kuptimin e fjalës, një peizazh natyror i përkryer. Ne do të vazhdojmë në zona të tjera të Shqipërisë, që janë zona të rëndësishme ekonomike, turistike”.

Faza e dytë e punimeve rehabilituese përfundon së shpejti, dhe do t'i japë kodrës mantelin e gjelbërt dhe shumëllojshmërinë e pemëve dhe bimëve dekorative. Ky projekt do të ketë impakt tejet të madh për qytetin e Durrësit. Kjo zonë ka qenë shumë problematike për qytetarët pasi gjatë reshjeve të shiut rrezikonte banorët dhe kalimtarët me rreshqitjen e dherave. Tashmë është zgjidhur problemi i rreshqitjes, por edhe do t'i ofrohet qytetarëve një park i bukur, i gjelbërt, i aksesueshëm për qytetarët dhe vizitorët. Me këtë projekt i jepet rëndësi e veçantë gjelbërimit dhe mbrojtjes së ekosistemit.

Projekti përfshin sigurinë teknike me rrjeta mbajtëse dhe mbjellje me pemë dhe me bar, në mënyrë që kjo kodër jo vetëm të mos rreshqasë më, por të jetë një vend frekuentimi nga qytetarët durrsakë.

Projekti përmban një pedonale, stola, ndriçim, vend për biçikleta etj. Përveç rehabilitimit do të realizohet edhe pyllëzimi i Kodrës nëpërmjet fidanëve të llojit rrap, selvi etj.

NË KËTË NUMËR:

KUR IDETË BËHEN REALITET....FQ.1

NGA VIZITA E MINISTRIT TË MJEDISIT NË ITALI FQ.2

LEJET MJEDISORE MARS 2015 – FQ.3-4

AKTIVITETET E MINISTRISË SË MJEDISIT NË MUJIN MARS

“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Europian. Përmbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitje dhe bashkërenduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.

MINISTRI KOKA “ITALIA MË PRANË ME INVESTIME NË FUSHËN E MJEDISIT”



Ministri i Mjedisit Z. Lefter Koka, zhvilloi një vizitë në Romë, Itali, në përgjigje të ftesës së bërë nga Z. Gian Luca Galletti, Ministri i Mjedisit dhe i Mbrojtjes së Territorit dhe Detit të Republikës Italiane.

Gjatë këtij takimi Ministri Koka vuri theksin tek reformat themeltare që janë ndërmarrë dhe po ndërmerren në fushën e mjedisit. Ndër të tjera ai përmendi punën e nisur për ndërtimin e Landfillave dhe rëndësinë e tyre. Ai shpalosi planet e menaxhimit në bashkëpunim me komunat, por të bërë të mundur ndarjen e mbetjeve në burim dhe menaxhimin sa më të mirë të tyre.

Ministri Koka u shpreh se po punohet në

drejtëm të patneritetit publik-privat dhe dhënien me koncesione të investimeve të ndryshme.

Ai i bëri thirrje edhe investitorëve italianë në fushën e mjedisit për të investuar në Shqipëri dhe siguroi Ministrin Galletti se Qeveria Shqiptare është e vendosur për të bërë reforma të suksesshme, dhe po punon për përshtatjen e plotë të legjislacionit shqiptar me atë të BE, dhe për këtë kërkoi edhe ndihmën e palës italiane.

Ministri Koka zhvilloi edhe një takim me Federambiente e cila përfshin 200 ndërmarrje të privatizuara të cilat operojnë në fushën e mbetjeve, mjedisit, dhe ujit.

Në këtë takim, Ministri Koka, bëri një përshkrim të situatës në vend dhe mundësisë së investimeve në fushën e mjedisit në Shqipëri.

Ministri Koka theksoi se është e nevojshme që në Shqipëri të hyjë teknologjia e re e cila ti shërbejë sa më mirë mbrojtjes së mjedisit.

Presidenti i Federambientit u përqendrua tek ndihma që mund të japin ndërmarrjet italiane

në fushën e mjedisit në Shqipëri, si dhe theksoi interesin që kanë shprehur këto ndërmarrje të investojnë në Shqipëri.

Ai shprehu interesin për investime, si përshebull ndërtimi i impianteve që shndërrojnë në energji djegien e mbetjeve urbane, e cila, sipas tij, do të siguronte edhe burim të ardhurash dhe ndikim pozitiv në ekonominë e vendit.

Ministri Koka zhvilloi një takim edhe me Z. Ermete Realacci, Presidentin e Komisionit të Mjedisit në Dhomën e Deputetëve. Ministri Koka e siguroi homologun e tij se Shqipëri po ecën me ritme të shpejta në rrugën drejt BE. Ai kërkoi mbështetjen dhe ekspertizën italiane për për të përshtatur legjislacionin shqiptar me atë të BE.

Z. Realacci u shpreh se e mbështet hyrjen e Shqipërisë në BE. Ai shtoi se bashkëpunimi midis dy vendeve tona në fushën e mjedisit është i rëndësishëm. Ai ofroi mbështetje të plotë për të ndihmuar me ekspertizë Shqipërinë në përshtatjen e legjislacionit me atë të BE.

TRAJNIMI I TRAJNUESVE PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR



Në muajin Mars në kuadër të projektit të Bashkimit Europian, ECRAN u organizua trajnimi i trajnuesve, për

procedurat, që duhet të ndiqen për hartimin e planeve programeve që duhet t'i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Ky trajnim dy ditë u organizua dhe zhvillua nga eksperitët e Ministrisë së Mjedisit në bashkëpunim me ekspertët e huaj, të cilët u fokusuan në zhvillimin e hartimit të planeve dhe programeve që duhet t'i nënshtrohen procesit të VSM-së, teknikat që përdoren dhe aftësitë që duhet të zhvillohen në planifikimin kombëtar dhe lokal.

Ky trajnim që një ndërthurje mes eksperiencës dhe legjislacionit që egziston në Shqipëri me eksperiencën dhe legjislacionin e kërkuar nga Bashkimi Europian për procesin e VSM-së.

Pjesëmarrësit në trajnim ishin përfaqësues të Ministrive të Linjës, si përfaqësues nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ekonomisë, si dhe përfaqësues të Sekretariatit Teknik të Ujërave. Ky trajnim ishte u zhvillua në pesë sesione:

Sesioni i parë ishte përshkrimi mbi VSM-në, mjetet dhe zhvillimi i tyre si dhe legjislacioni vendas dhe i Bashkimit Europian.

Sesioni i dytë ishte përshkrimi i parimeve kryesore të VSM-së, praktikat më të mira, përshkrimi i hapave kryesore që ndjek VSM-ja si dhe aktorët kryesorë të përfshirë në procesin e VSM-së.

Hapat kryesorë analitik nëpër të cilat kalon procesi i VSM-së ishte temë e **sesionit të tretë**, duke sjellë frymën dhe objektivin që ka procesi i VSM-së. Gjithashtu, në këtë sesion u dhanë dhe shembuj konkretë mbi të cilët punohej për të kuptuar si duhej ky sesion.

Konsultimi i palëve të interesuara ishte **sesioni i katërt** i këtij trajnimi, pjesë që shpjegonte se si mund të bëhej eficient ky proces shumë i rëndësishëm për hartimin, si dhe për zbatueshmërinë e planeve dhe programeve që i nënshtrohen procesit të VSM-së.

Në **sesionin e pestë** u trajtua Vendimarrja në procesin e VSM-së, ku sqarohet nëpërmjet shembujve se çfarë produktesh duheshin marrë parasysh përpara se të adoptohej një plan apo program apo për të aprovuar një projekt.


Të pranishmit qenë mjaft aktivë gjatë të dy ditëve të trajnimit, pasi fusha e punës së tyre kërkonte shpesh të përballeshin me plane e programe që duhet t'i nënshtroheshin procesit të VSM-së.



VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS MARS 2015

NR	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1	PROJEKTI UJIT PIJSHËM	VNM TH Ndërtim dhe rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit.	Durrës	Deklaratë Mjedisore
2	ENTI KOMBËTAR I BANESAVE	VNM P Banesa 38 apartamente njësi shërbimi	Lushnjë, Fier	Vendim për VNM Paraprake
3	DORUZ	VNM TH Shfytëzim i mineralit ranor pllakor.	Dhorës, Skrapar Berat	Deklaratë Mjedisore
4	DOBRUSHI 2010	VNM TH Karrierë shfytëzimi të gurit gëlqeror	Zona minerale 56/2, Skrapar, Berat.	Deklaratë Mjedisore
5	KOLA	VNM P Stabiliment për ambalazhim uji të pijshëm	Qelëz, Shkodër	Vendim për VNM Paraprake
6	PAVARËSIA 2007	VNM P shtesë katesh	Durrës	Vendim për VNM Paraprake
7	HP VENDRESH ENERGY	VP - HEC, pellgu ujëmbledhës, Përroi i Vendreshës	Komuna Vendresh, Skrapar, Qarku Berat	Vendim për VNM Paraprake
8	RAJAN ENERGY 1045	VNM P Ndërtim me koncension HEC	Mesare, Ersekë	Vendim për VNM Paraprake
9	RAJAN ENERGY 1035	VNM P Ndërtim me koncension HEC	Arrëz, Ersekë	Vendim për VNM Paraprake
10	RAJAN ENERGY 1048	VNM P Ndërtim me koncension HEC	Gradishtë, Erseke	Vendim për VNM Paraprake
11	RAJAN ENERGY 1051	VNM P Ndërtim me koncension HEC	Rajan 2, Ersekë	Vendim për VNM Paraprake
12	RAJAN ENERGY 1052	VNM P Ndërtim me koncension HEC	Shëndelli, Ersekë	Vendim për VNM Paraprake
13	RAJAN ENERGY 1049	VNM P Ndërtim me koncension HEC	Radon, Ersekë	Vendim për VNM Paraprake
14	RAJAN ENERGY 1056	VNM P Ndërtim me koncension HEC	Sotirë, Ersekë	Vendim për VNM Paraprake
15	RAJAN ENERGY 1058	VNM P Ndërtim me koncension HEC	Podë , Ersekë	Vendim për VNM Paraprake
16	RAJAN ENERGY 1060	VNM P Ndërtim me koncension HEC	Dedovë, Ersekë	Vendim për VNM Paraprake
17	RAJAN ENERGY 1061	VNM P Ndërtim me koncension HEC	Peshtan, Ersekë	Vendim për VNM Paraprake
18	RAJAN ENERGY 1062	VNM P Ndërtim me koncension HEC	Osnat, Ersekë	Vendim për VNM Paraprake
19	BASHKIA DIVJAKË	VNM P Ndërtim i qendrës spitalore	Divjakë	Vendim për VNM Paraprake
20	KNAUF- TIRANA	VNM P Ndërtim rruge	Dibër	Vendim për VNM Paraprake
21	CO - BETON	VNM P Ndërtim Kapanoni	Rrashbull, Durrës	Vendim për VNM Paraprake

BOTOHET KATALOGU “RIKTHIMI I JETËS”



Ministria e Mjedisit ka publikuar këto ditë botimin “Rikthimi i jetës - 1 vit moratorium i gjuetisë”. Ligji “Për shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë” nr. 7/2014, datë 30.1.2014 vendosi ndalimin e ushtrimit të gjuetisë në vend për një periudhë 2- vjeçare, deri në Mars 2016.

Ky katalog sjell në mënyrë vizuale kënaqësinë e shtimit të faunës së egër, në zona të cilat prej kohësh e kishin humbur jetën e shpendëve dhe folelizimin e tyre.

Studimet tregojnë se Shqipëria strehon mesatarisht 180 mijë shpendë dimërues, shifër kjo e lartë për sipërfaqe ujore relativisht të vogla.

Të paktën 5 ligatina shqiptare, të cilat bëjnë pjesë në ekosistemet e zonave të mbrojtura dhe me një biodiversitet të pasur, si: Karavastaja, Narta, Shkodra, Ohri, Prespa e Madhe plotësojnë kriteret për zonat me rëndësi ndërkombëtare dhe janë shpallur zona Ramsar si ligatina me rëndësi ndërkombëtare për shpendët migratorë të ujit.

Këto zona përbëjnë habitate tepër të vlefshme jetike për më shumë se 18 lloje shpendësh uji shtegtarë. Kjo tregon rëndësinë që ka natyra e Shqipërisë për shpendët e ujit, duke nxjerrë në

pah edhe përgjegjësinë e shtetit shqiptar për ruajtjen e zonave me rëndësi ndërkombëtare dhe për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara.


Këto zona tashmë dëshmojnë se rosa e egër apo lloje të tjera shtegtare, kanë ardhur këtë fund vit të dimërojnë në vendin tonë dhe kanë populluar lagunat dhe ligatinat në të gjithë vendin.

Kënaqësinë e kësaj arritjeje Ministria e Mjedisit e ka ndarë dhe me Ministrinë e tjera, si dhe donatorët dhe ambasadat e vendeve mike në Shqipëri.

LEJET MJEDISORE SHTATOR 2014

NR	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1	TIRANA CASH & CARRY	VNM P - Ndërtimin e objektit "Qëndër për grumbullimin, magazinimin, ambalazhimin, distribucionin dhe tregtimin e produkteve industriale bujqësore dhe blegtorale "	Fshat i Gropaj, Vaqarr, Tiranë	Vendim paraprak
2	KRYPI - ABA	VNM TH- Nxjerrja e mineralit të kromit	Objekti i kromit, "Qafa e Lëgut", Martanesh, Bulqizë, Dibër	Refuzim
3	ALION SHPK	VNM TH- Karrierë e shfrytëzimit të ranoreve pllakore, në zonën minerare 56/5	Skrapar, Berat	Deklaratë
4	UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË 0287	VNM P Rrjet kanalizimi në rrugën Teodor Keko	Unazë e madhe, Tiranë	Vendim paraprak
5	UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË 0289	Ndërtim depo uji 4000 m3, Yzberisht	Ish Reparti Ushtarak në Kodër Yzberisht, Komuna Kashar, Tiranë	Vendim paraprak
6	UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË 0290	VNM P- Rrjet kanalizimi në rrugët që kufizohet "Hamdi Cenceimeri", "Fadil Hadushaj" dhe "Nexhat Agolli"	Kombinat, Tiranë	Vendim paraprak
7	UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË 0292	VNM P Ndërtim rrjet kanalizimi "ish Uzina Dinamo"	Ish Uzina Dinamo, Tiranë	Vendim paraprak
8	MEGAPHARMA	VNM P Rikonstruksion i depos farmaceutike	Farkë, Tiranë	Vendim paraprak
9	LEON 2011	VNM P Objekt shërbimi dhe banimi	Vlorë	Vendim paraprak
10	KROI MBRET ENERGI	VNM TH, Ndërtim Kaskade HEC	Potom, Skrapar, Berat	Deklaratë
11	ALBTEK ENERGJI	VNM TH, Impiant përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve urbane	Elbasan	Deklaratë

Nr	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDODHJA	VENDIMI
1	BLEDI	VP - Shfrytëzim minerali kromi Galeria 18, 19, 20	Vendburimi i Kromit "Theken", Krastë, Bulqizë, Qarku Dibër	VNM Paraprake
2	GENTARI	VP - Shfrytëzim minerali kromi, Galeria 36 dhe 38, zona qëndrore Bulqizë	Qarku Bulqizë	VNM Paraprake
3	PËRFUNDI 2010	VTH - Nxjerrje e gurit gëlqeror objekti "Pishkash"	Komuna Qukës, Librazhd, Qarku Elbasan	Deklaratë Mjedisore
4	DOVA FAT.	VP - Nxjerrje e mineraleve nga marina ose llumrat lumore	Mifol, Novoselë, Vlorë	VNM Paraprake
5	HP VENDRESH ENERGI	VP - HEC, pellgu ujëmbledhës, Përroi i Vendreshës	Komuna Vendresh, Skrapar, Qarku Berat	Shtyhet
6	BASHKIA MAMURRAS	VP - Ndërtimi K.U.Z, Fshati Drojë	Bashkia Mamurras, Kurbin, Qarku Lezhë	VNM Paraprake
7	TREMA ENGINEERING 2	VP - Kapanon industrial për magazinimin e materialeve dhe mjeteve të ndryshme dhe servis mjetesht	Fshati Hasan, Fushë Krujë, Durres	VNM Paraprake
8	STONE GROUP ALBANIA	VTH - Karrierë e ranorit silicor, në të djathtë të lumit të shushicës	Hore Vranisht, Kuç, Vlorë	Refuzim Deklaratë Mjedisore
9	AL - GEM	VTH - Shfrytëzim i gurit gëlqeror	Përroi i Karabashit, Mamurras, Kurbin	Deklaratë Mjedisore
10	KONSTRUKSION 93	VTH - Shfrytëzimin e mineralit gur gëlqeror dhe linjë prodhimi inertesh nyje fraksionimi, magazinim i tyre, import export dhe njësi shërbimi në funksion të aktivitetit	Fshati Progër, Devoll, Korçë	Deklaratë Mjedisore
11	ARTI	VNM P Impiant për prodhimin e asfalto - betonit	Delvinë, Finiq, Vrion, Vlorë	VNM Paraprake



THËNIA E MUAJIT

“Unë nuk jam thjesht ambientalist. Unë jam gardiani i Tokës”

Darryl Cherney

SEKTORI I TRANSPARENÇES DHE KOMUNIKIMIT
Email: info@moe.gov.al

NGA AKTIVITETET E MINISTRISË SË MJEDISIT



DËGJESA ME PUBLIKUN

Organizohet dëgjesa e Publikut për Strategjinë ndërsektoriale të Mjedisit. Kjo dëgjese u drejtua nga Drejtori i Përgjithshëm i Politikave Mjedisore dhe Jetësimit të Prioriteteve z. Pëllumb Abeshi.

Në takim merrnin pjesë një numër i limituar i organizatave jofitimprurëse që veprojnë në fushën e mjedisit, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare të huaja, financues të projekteve në fushën e mjedisit, si dhe përfaqësues nga Njësia e Programimit të Strategjive në Këshillin e Ministrave dhe Delegacionit Europian.

Z. Abeshi i njohu të pranishmit me punën e bërë për hartimin e kësaj draft strategjie, e cila është hartuar nga një grup ekspertësh të Ministrisë së Mjedisit në bashkëpunim me përfaqësues të Ministrive të linjës. Gjithashtu z. Abeshi theksoi se kjo Strategji është pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, gjithashtu përfshin dhe strategjitë e tjera të fushave të veçanta të Mjedisit si strategjinë e cilësisë së ajrit, strategjinë e biodiversitetit etj.

Të pranishmit bënë komente mbi draftin e paraqitur të cilat do të shqyrtohen nga grupi i punës, që e ka hartuar draft strategjinë dhe do përfshihen në këtë material.

Për gjithë të interesuarit, bëjmë me dije se afati i komenteve do jetë *deri në fund të muajit prill* dhe më pas ky material do jetë objekt i një tryeze të rumbullakët me donatorët që veprojnë në fushën e Mjedisit.

Komentet mund të dërgohen elektronikisht në adresën zyrtare të Ministrisë së Mjedisit. (info@moe.gov.al)



ELBASAN FIL-LON PUNA PËR INCINERATORIN

Gjatë muajit Mars nisi puna për ndërtimin e Impiantit për përpunimin e mbetjeve urbane, në qytetin e Elbasanit.

Më 16 mars Kryeministri i vendit z. Edi Rama, Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan, z. Qazim Sejdiu, ishin të pranishëm në inaugurimin e një prej projekteve më të mëdha në fushën e mjedisit, ndërtimin e një impianti, i pari i këtij lloji në vendin tonë. Është ky një investim prej 22 milionë euro që parashikon t'i japë zgjidhje problemit serioz të trajtimit të mbetjeve urbane dhe t'i shndërrojë ato në energji.

Impianti, është vendosur në vendgrumbullimin e mbetjeve në anë të ish kombinatit metalurgjik në Elbasan, që ishte kthyer në një rrezik serioz për shëndetin dhe mjedisin për qytetin dhe zonat përreth, ku gjenerohen rreth 120-140 tonë mbetje të ngurta urbane.

Projekti parasheh avantazhe jo vetëm për Elbasanin, por edhe më gjerë. Nga njëra anë, i jepet zgjidhje një problemi serioz në vend, mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve, por nga trajtimi teknologjik i tyre do të përfitohet edhe energji e gjelbër. Në fazën e shfrytëzimit është parashikuar të prodhohet rreth 17 250 MWh energji në vit. Projekti i kushton rëndësi të posaçme, përmbljes së kërkesave teknologjike dhe mjedisore sipas standardeve europiane.

Impianti do të ketë në përdorim një teknologji bashkëkohore, që siguron shmangien e çdo ndikimi negativ në mjedis. Sipas drejtuesit të projektit, Ernesto Granelli, falë kësaj teknologjie që siguron djegie në 360 gradë, në impiant mund të trajtohen edhe mbetje spitalore. Po ashtu, projekti parashikon edhe krijimin e një brezi të gjelbëruar përreth digës.

Projekti vlerësohet të sjellë ndikim edhe në ekonominë lokale. Nga përpunimi i mbetjeve parashikohet të sigurohen rreth 400 tonë skrap dhe plastikë në vit, prej të cilave vlerësohet të gjenerohet një e ardhur vjetore prej 90 mijë euro.

